

VENDIM
Nr. 279, datë 30.12.2024

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR PERIUDHËN 2025–2027

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “c”, pika “i”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15 dhe nenit 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018, “Për miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1859/25 prot., datë 16.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 192, datë 18.9.2024, vendosi për: “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OST” sh.a., për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025–2027”.

- ERE gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit, në kuadër të nevojës për sqarime të mëtejshme, në lidhje me çështjet e evidentuara në aplikim, i ka dërguar shoqërisë “OST” sh.a. kërkesat për informacion me nr. 1859/2 prot., datë 20.9.2024, si dhe nr. 1859/12 prot., datë 20.11.2024, në përgjigje të së cilave “OST” sh.a. ka përcjellë korrespondencat me nr. 6004/2 prot., datë 7.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/4 prot., datë 9.10.2024, dhe nr. 6004/7 prot., datë 2.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 1859/19 prot., datë 3.12.2024.

- Më datë 28.10.2024, u zhvillua seanca teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë “OST” sh.a., lidhur me informacionin, argumentet dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria në aplikim.

- Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ERE zhvilloi më datë 6.12.2024, seancën zyrtare publike me përfaqësues nga shoqëria “OST” sh.a., si dhe me palët e interesit, lidhur me aplikimin për përcaktimin e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025–2027.

- Në zbatim të afateve të përcaktuara në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, është kryer publikimi në faqen elektronike të ERE-s, www.ere.gov.al, i aplikimit, çdo korrespondence të depozituar nga shoqëria “OST” sh.a., si dhe i komenteve të kryera nga palët e interesit.

- Shoqëria “OST” sh.a. ka depozituar parashikimin e saj, lidhur me kërkesën për energji për periudhën rregullatore 2025–2027, mbështetur në mesataren historike të energjisë të transmetuar nga “OST” sh.a., për konsum, si dhe gradientin në rritje të kërkesës për energji prej 0.29 %.

- “OST” sh.a., me shkresën nr. 1859/19 prot., datë 3.12.2024, “OST” sh.a. deklaroi se në vlerësimin e kryer, në lidhje me konsumin në rënie për vitin 2026 dhe 2027, është marrë në konsideratë integrimi i parqeve fotovoltaike që pritet të futen në operim, si dhe “Vetëprodhues-it” që prodhojnë energji elektrike, e cila konsumohet kryesisht në rrjetin shpërndarës.

- Kostoja e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën 2025–2027, i janë referuar çmimeve të publikuara për secilën periudhë respektive në HUDEX, i cili bë kushtet ku Bursa Shqiptare e Energjisë nuk ofron ende produkte derivative, konsiderohet si një ndër tregjet më përfaqësuese të rajonit.

- Vlera e shpenzimeve ndihmëse për periudhën e ardhshme rregullatore është përlllogaritur duke u bazuar në koston mesatare të realizimit për vitet 202–2023, si dhe në koston e pritshme për mbylljen e vitit 2024.

- Baza e Rregulluar e Aseteve dhe Amortizimi i akumuluar është vlerësuar në të ardhurat e kërkuara sipas koston historike të deklaruar nga “OST” sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 247, datë 18.11.2024, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë “OST” sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027. Në rrethanat, ku procedura për miratimin e “Planit të investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027” gjendet ende në proces, u konsiderua se investimet të cilat mund të pranohen në bazën e rregulluar të asetëve për periudhën 2025–2027 të ishin vlerat e paraqitura në dokumentin e sipërcituar, për të cilin ERE pritet të dalë me një vendim.

- Në zbatim të nenit 7, pika 4.2.6. të “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të transmetimit”, në rast se “Plani i investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027”, i miratuar nga ERE, do të ketë ndryshime nga sa propozuar nga shoqëria “OST” sh.a, ERE do të konsiderojë rishikimin e CAPEX-it lidhur me investimet që priten të realizohen nga “OST” sh.a., në periudhën pasardhëse.

- Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit të shoqërisë “OST” sh.a. për periudhën 2025–2027 është përlllogaritur në nivelin 2.46%.

- Nga shqyrtimi i të dhënave të aplikimit, si dhe pasqyrave financiare të shoqërisë, u konstatua se gjatë periudhës 2022–2023, si dhe tetëmujorit të mbyllur të vitit 2024 “OST” sh.a. ka realizuar të ardhura nga tregu i balancimit.

- Shoqëria ka deklaruar në korrespondencat e saj gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit se: “Bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit, neni 12.3, përkatësisht pika 3.5, “Komponenti Nxitës”, parashikohet korrektimit i çmimeve të disbalancave nëpërmjet një komponenti nxitës, për të cilën “OST” ka hartuar një procedurë dhe ju është bërë me dije palëve që operojnë tregun...”, procedurë për të cilën duhet të bëjë me dije dhe ERE.

- “OST” sh.a. duhet të hartojë dhe zbatojë një mekanizëm për shpërndarjen e këtyre të ardhurave, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit, si dhe duhet të korrektojë komponentin nxitës, me qëllim garantimin e neutralitetin të saj financiar të rregulluar, lidhur me shërbimet e balancimit në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, të Bordit të ERE-s, dhe të bëjë me dije ERE-n mbi masat e marra për zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi.

- Të ardhurat e realizuara në periudhën 2022–2024 nga alokimi i kapaciteteve, si dhe ato të parashikuara për periudhën 2025–2027, sipas vlerësimeve të ERE-s, janë konsideruar si të zbritshme nga të ardhurat e kërkuara.

- Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 2025–2027 rezultojnë: a) 0.82 lekë/kwh për vitin 2025; b) 0.86 lekë/kwh për vitin 2026; c) 0.88 lekë/kwh për vitin 2027.

- Nga sa më sipër, tarifa e transmetimit për periudhën rregullatore 2025–2027, rezulton 0.85 lekë/kwh.

- ERE do të rishikojë të ardhurat e kërkuara përgjatë periudhës rregullatore, në përputhje me përcaktimet e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, prej 0.85 lekë/kwh.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti